

**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË**

**S T U D I M E
H I S T O R I K E**

3 - 4

REDAKSIA

Akademik BEQIR META (kryeredaktor),
Akademik asoc. MARENGLËN VERLI (zëvendëskryeredaktor), prof. assoc. dr. LEDIA
DUSHKU (sekretare shkencore), (anëtarë) prof. dr. PËLLUMB XHUPI, prof. dr.
MUHARREM DEZHGIU, prof. dr. HAMIT KABA, prof. dr. ANA LALAJ, prof. dr.
FATMIRA MUSAJ, prof. dr. ERIKETA KAMBO, prof. assoc. dr. SABIT SYLA, prof.
dr. SABILE KEÇMEZI, prof. assoc. dr. DRITAN EGRO, prof. assoc. dr. FRASHËR
DEMAJ, dr. SONILA BOÇI, dr. EDMOND MALAJ

Redaktore gjuhësore: Meliha BALLA
Arti grafik: Mirela MIHALI

© Copyright: Instituti i Historisë i Qendrës së Studimeve Albanologjike

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Del çdo gjashtë muaj

Pronë letrare e Institutit të Historisë
i Qendrës së Studimeve Albanologjike

Adresa e redaksisë: Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë
Telefax: 2225869

EMINE BAKALLI

**VËSHTRIM KRITIK MBI INTERPRETIMET RRETH
“DOKUMENTIT JUGOSLLAV GJASHTËMBËDHJETË
PIKËSH” PËR “MARRËVESHJEN AUTENTIKE ZOGU-
PASHIQ” TË VITIT 1924**

Përkufizimi i çështjes

Këto vitet e fundit është aktualizuar në plan të gjerë “Marrëveshja Gjashtëmbëdhjetë Pikëshe Zogu-Pashiq e vitit 1924”. Preokupimi për këtë “marrëveshje” dhe “dokumentin dokumentues” të saj në rrafshin historiografik po dhe atë mediatik¹ mori hov me rastin e ngritjes të përmendores të Mbretit Zog në njërin ndër sheshet e Tiranës në 100-vjetorin e shtetit shqiptar, në vitin 2012. Deri më sot në këto rrafshë komunikimi, “Marrëveshja Zogu-Pashiq” dhe “dokumenti autentik” për të, është shndërruar në një instrument për vlerësimin dhe rivlerësimin e figurës historike të Ahmet Zogut. Por, theksi i këtij vështrimi nuk ka të bëjë me këtë figurë historike, pra me historinë, por me mënyrën e trajtimit dhe interpretimit të burimit qoftë ai *dokument arkivor* apo dhe *burim historiografik*, nga një pjesë e komunitetit historiografik shqiptar.

Siç dihet, fillet të cilat hapën rrugë për statusin shkencor të historiografisë lidhen pikërisht me dokumentin-dëshmi dhe identifikimin e autenticitetit të tij. Kjo nga se jo rrallë në të kaluarën e njerëzimit janë bërë falsifikime dokumentesh për interesa personale, gruporë, shtetërorë, ekonomikë, politikë apo ndonjë interesi tjetër. Bardi i Shkollës së Analeve Marc Bloch, vitin e botimit të *De re diplomatica* (1681), e quan “datë të madhe në historinë e mendimit njerëzor”², sepse me këtë botim përfundimisht u vunë themelet e kritikës së dokumenteve arkivore. Ai merr dhe një shembull nga e kaluara e largët kur në një seancë gjyqësore një fisnik po ballafaqohej me vringëllimën e “dokumentit” akuzues nga

¹ Shtëpitë televizive të Kosovës organizuan debate, ku antizogistët e përbetuar me këtë “marrëveshje” e pa këtë “marrëveshje” vringëllonin kundër kësaj figure historike. Pezmi antizogist i tyre reflektonte besim katekizistik në propagandën e një kohe, jehona e së cilës po ndihet sot e kësaj dite.

² March Bloch, *Apologji për historinë ose mjeshtëria e historianit*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2003, f. 89.

disa murgj duke thënë: “Me ngjyrë shkrimi, kushdo qoftë mund të shkruaj çfarëdo qoftë”³

Sigurisht që, e para e punës për historianin është që në mënyrë të ndërgjegjshme të hulumtojë, gjejë dhe grumbullojë dokumente dhe dëshmi të tjera për objektin e studimit të tij qoftë ajo ngjarje historike, personalitet historik, proces historik apo zhvillim historik në këtë apo atë segment gjallimi në superstrukturën shoqërore po dhe zhvillime në fusha të ndryshme të jetës së përditshme të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore nga e kaluara. Ndërsa, hapi i dytë, po aq i rëndësishëm, është identifikimi i autenticitetit të dokumentit-burimit dhe në fund leximi apo interpretimi profesional i tij. Madje, analiza duhet shkuar deri aty që historiani specialist të lexojë dhe *porosinë e fshehtë* të atij dokumenti. Të gjitha këto janë parakushte themelore për një studim të qëndrueshëm shkencor. Ky drejtpeshim profesional funksionon atëherë kur brenda *kriter-aktorit* kryesor historiografik- *historianit*, ndodh interferencë e nënkuptueshme-avancuese ndërmjet etikës njerëzore dhe asaj profesionale. Një historian me etikë profesionale, shtyllë e së cilës është qëndrimi kritik ndaj burimeve e me qëllim të përkufizimit të së vërtetës historike dhe asgjë pos së vërtetës, vështirë se mund të instrumentalizojë të kaluarën për qëllime jashtë shkencore. Po kështu etika profesionale nuk lejon që të keqinterpretohet puna dhe rezultati shkencor i tjetrit, gjë që ndodh në rastin “tonë”.

³ *Po aty*, f. 87.

Profili i “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit”⁴ apo i “dokumentit autentik” për “Marrëveshjen Zogu-Pashiq”

Sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, po dhe gjithë fjalorëve të tjerë, fjala cilësuese (mb.) *autentik*, do të thotë diçka që është “i sigurt, i vërtetë; origjinal; burim autentik; dokument autentik; që është vërtetuar zyrtarisht

⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1925, Dosja (më tej: D.) 105, fl. 4-5; Teksti i përkthyer i “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit”: “NXERJE KOPJE E MARRËVESHJES TË PËRFUNDUAR NË BELGRAD NË GUSHT TË 1924 MIDIS PRESIDENTIT PACHICH dhe AHMET ZOGUT

1. Shqipëria impenjohet të bashkohet Jugosllavisë me bashkim personal.
2. Kryetari i Shtetit Shqiptar do të jetë Ahmet Zogu, që më vonë do të njohi dinastinë Caragiorgvitch.
3. Qeveria jugosllave me gjithë mjetet diplomatike dhe ushtarake do të njohi Ahmet Zogun si kryetar Shteti përgjatë jetës, dhe i atribuon menjëherë një kontribut vjetor të shtetit.
4. Ministria e luftës Shqiptare do të anulohet dhe Shqipëria heq dora që të ketë një ushtri kombëtare.
5. Shqipëria do të mbajë një gjindarmëri aq të fortë sa të mbajë qetësinë e brendshme të vendit, për të ndaluar e çfarosur çdo lëvizje të ngritur kundër Ahmet Zogut dhe kundër regjimit të vendosur prej tij.
6. Në këtë gjindarmëri do të bëjnë pjesë edhe oficerë rusë të ish ushtrisë të Gjeneralit Wrangel, që nashit ndodhet në Jugosllavi. Qeveria e Jugosllavisë do ta mbajë atë gjindarmëri me mjete financiare dhe armë.
7. Në gjindarmëri mund të hyjnë për të shërbyer edhe oficerët Jugosllavë dhe të tjerë që Qeveria Jugosllave do të pranojë n'interes të dy vendeve.
8. Midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë do të stabilizohet një bashkim doganor në bazë së cilës akordohet liri e plotë importimeve dhe exportimeve të mallrave të dy vendeve. Edhe transiti nëpërmjet kufive të dy vendeve do t'jetë i lirë për ushtarakët e dy vendeve.
9. Përfaqësuesit e jashtëm Jugosllavë do të ngarkohen edhe për interesat e Shqipërisë, e cila heq dorë që të mbajë zyra diplomatike dhe konsullata të saja jashtë shtetit.
10. Qeveria Shqiptare duhet të deklarojë pran Konferencës t'AMBASADORVE në Paris që tërheq pretendimin e sajë për sovranitetin mbi Monastir Shën-Naum dhe lokalitetet e Vermoshit e Klimentit, që mbetën në zotërimin të Jugosllavisë.
11. Kisha Ortodokse Shqiptare do të tërhiqet nga Patrikana e Konstantinopolit dhe të bashkohet gjerarkis Ortodokse të Beogradit, kështu dhe Muftinija Myslimane Shqiptare do të varret nga ajo jugosllave.
12. Qeveria Shqiptare do të heq dorë nga një politikë ngushtësisht kombëtare dhe nuk do të interesohet nga elementi shqiptar jashtë kufijve të vetë. Ajo impenjohet veç kësaj që të mos pranojë në tokën e saj Kosovarët dhe elemente të tjerë të ditur dhe të dyshimtë në sentimentet e tyre kundërshtarë të politikës jugosllave.
13. Për çdo konçesion që Shqipëria do të bëjë vendeve të tjera, ajo është e detyruar të marrë pëlqimin nga Jugosllavia.
14. Në qoftë se Jugosllavia është në luftë me Bullgarinë dhe Greqinë, qeveria Jugosllave do të ketë të drejtën të rekrutojë në Shqipëri një ushtri prej 25.000 vullnetarësh me qëllim për t'i përdorur në frontin t'Italisë dhe të Greqisë kundrejt Shqipërisë, ushtria Jugosllave do të ketë drejtë të okupojë gjithë tokën Shqiptare, për të siguruar kështu Shqipërisë gjithë tokën e saj nga invadimi eventual Italian ose Grek.
15. Qeveria shqiptare nuk mund të deklarojë luftë asnjë shteti, pa pëlqimin preventiv të Jugosllavisë.
16. Ky traktat është sekret dhe nuk mund të zbulohet e të shtypet e të dy palëve.

sipas origjinalit, që përputhet plotësisht me origjinalin. *Kopje autentike...*⁵. Shtrohet çështja: A është zbuluar, pra a kemi dokument *autentik* apo *kopje autentike* të një dokumenti i cili dëshmon për një marrëveshje “Zogu-Pashiq” të gushtit 1924, prej gjashtëmbëdhjetë pikash apo nenesh? Dokumenti të cilit i referohen një numër jo i vogël historianësh shqiptarë, a është një *dokument-përmbajtje autentike* siç e cilësojnë këta, apo një faqe A-4 me gjashtëmbëdhjetë pika e cila i është servirur shërbimit diplomatik italian nga ku ta dimë kush, në një kohë (nëntor 1925, janar 1926) e në dy vende (Jugosllavi, Shqipëri) dhe sigurisht me një qëllim: atë politik. Pra, cila është fizionomia e dokumentit “Gjashtëmbëdhjetë Pikësh” të cilit i referohen këta historianë? Njëri ndër ta, mbase për të ngritur adrenalinën tek lexuesi konstaton se marrëveshja “...u mbajt e fshehtë për gati 60 vjet”⁶. Kush e mbajti të fshehtë: Beogradi, Roma apo ndoshta Tirana? Përse do ta mbanin të fshehtë, kushdo qoftë (pushteti, qarqet shkencore) në këto vende? Por, sa i qëndrueshëm është ky konstatim kur dihet se kjo “Marrëveshje” u botua e plotë në vitin 1967.

Për hir të së vërtetës, një marrëveshje e mundshme e Ahmet Zogut me qeverinë jugosllave u përfol që në vitin 1924⁷. Kurse për një “Marrëveshje Zogu-Pashiq” nisi të shkruhej duke filluar me shtypin grek, që në verën e vitit 1925⁸. Është interesant se shtypi grek kishte të “dhëna” për një “marrëveshje” të tillë para se kjo t’i bjerë në dorë shërbimit diplomatik italian. Konsulli shqiptar në Selanik i shqetësuar nga këto shkrime në të cilat pohohej se “Shqipëria do të bashkohesh me Jugosllavinë si një shtet i konfederuem”, kërkonte nga baza e tij autorizim për përgënjeshttrimin e tyre⁹. Askush nga historianët që u morën me këtë “marrëveshje” nuk e ka shtruar çështjen nga u informua shtypi grek për të? A mund të publikohej diçka e tillë në shtyp pa lejen e shërbimeve përkatëse greke, pasi dihet mirëfilli relacioni politikë-shtyp, sidomos në kohët e diktaturave. E Greqia në atë kohë po gjallonte nën një

⁵ *Fjalor i shqipes së sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 67.

⁶ Kristo Frashëri, *Ahmet Zogu - Vështrim historik*, Tiranë: M&B, 2014, f. 66.

⁷ Arben Puto, *Demokracia e rrethuar*, Tiranë: 8 Nëntori, 1990, f. 57. “Flitej madje edhe për marrëveshje të fshehta midis Zogut dhe qeverisë jugosllave”, evidencon autori duke iu referuar burimeve dokumentare diplomatike italiane të botuara (*I Documenti Diplomatici Italiani* (më tej: *DDI*), 7 serie, vol. III, d. nr. 66, p. 44).

⁸ *Liria Kombëtare*, 2 shtator 1925, f. 1, shkruante “...mbi traktatin e mshehtë të gushtit 1924, që u shpall në shtypin grek”.

⁹ *AMPJ*, F. 251, V. 1925, D. 106, fl. 24, Selanik, 22 shtatuer 1925.

diktaturë të “ngrefosur” të gjeneralit Pangallos¹⁰, e i cili kishte bërë urrejtje kundër Bullgarisë dhe i vringëllonte Turqisë. A mund të ishte “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi” rezultat i njëfarë bashkëpunimi të “nëntokës” serbo-greke apo ndoshta një produkt i vetëm asaj greke? Si u bë që në versionin e dokumentit të servurur në Shqipëri, që ishte në italisht, në vend të “kossovare”, siç do të thoshin italianët, evidencohet “cossoviotti”, siç e thonë grekët. Detaj i vogël që flet shumë. Si të shpjegohet ndryshe, përveç që një “greku” i ka shpëtuar ky detaj me rastin e përkthimit të “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit” nga greqishtja në italisht?

Në fakt, “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi” u publikua për herë të parë në vitin 1967, nga historiani italian Pietro Pastorelli në një studim voluminoz, që ka të bëjë me rrjedhat paraprijëse diplomatike të Paktit të Dytë të Tiranës të 22 nëntor 1927¹¹, natyrisht me një analizë përcjellëse. Ky autor precizon se shërbimit diplomatik të Romës (atasheut ushtarak italian në Beograd, Sebastino Praksa, në nëntor 1926 dhe të ngarkuarit me punë italian në Shqipëri Tomaso Assereti, pak më vonë) i kishte rënë në dorë një përmbajtje identike për një marrëveshje Zogu-Pashiq të gushtit 1924, prej gjashtëmbëdhjetë pikash. Pastorelli shpreh rezerva jo të vogla për autenticitetin e këtij dokumenti, pra dhe përmbajtjes së tij, për shumë arsye duke u nisur që nga vetë mënyra se si i ishte servur shërbimit diplomatik italian. “Nuk do të jetë asnjëherë e lehtë të vendosësh nëse marrëveshja të ketë ndodhur me të vërtetë. Është shumë e dyshimtë që Kontarini të ketë besuar në ekzistencën e saj, Musolini nëse nuk ka qenë krejtësisht i bindur, të paktën e konsideronte të mundshme...”¹². Prandaj, ky autor flet për një “marrëveshje të supozuar”¹³.

Ndërkaq, një variant identik në përmbajtje, i dokumentit të cilin e boton Pastorelli dhe që gjendet në arkivat italiane, është arkivuar edhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë në Fondin 251, Viti 1925, Dosja 105. Dosja në fjalë, përmban kopjen e shkresës përcjellëse të të Ngarkuarit me Punë italian në Shqipëri Assereti, që mban

¹⁰ Richard Clogg, *Histori e përmbledhur e Greqisë*, Tiranë: Toena, 2004, f. 108.

¹¹ Pietro Pastorelli, *Italia e Albania 1924-1927, Origini diplomatiche del Trattato di Tirana del 22 novembre 1927*, Firenze: 1967. Është fjala për Paktin e Dytë të Tiranës me karakter ushtarak.

¹² *Po aty*, f. 221.

¹³ *Po aty*.

datën 9 janar 1925; një faqe me gjashtëmbëdhjetë pika në italishte dhe përkthimi i këtij materiali në gjuhën shqipe. Çështja se nga erdhi dhe kur u sistemua kjo kopje në Arkivin Qendror Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, ku gjendej më parë i tërë fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare (251), mbetet e paqartë. Por ajo që është krejt e qartë, qoftë për një historian fare fillestar, është se njëfaqëshi prej gjashtëmbëdhjetë pikash në italisht nuk mund të ketë status dokumenti zyrtar apo status *kopjeje autentike* të ndonjë dokumenti zyrtar. Në krye të fletës evidencohet sa vijon: “ESTRATTO Copia dell’ intesa conclusa a Belgrado nell’ Agosto 1924 tra il PRESIDENTE PACHICH ed AHMET ZOGU”. Pasojnë 16 pika po në italisht. Sigurisht që një marrëveshje Beograd-Tiranë (midis një shqiptari e një serbi), nuk do të kishte italishten si gjuhë dhe as që do të kishte nevojë përkthimi për shërbimin italian të një dokumenti që po të ishte autentik si zakonisht do të ishte në frëngjisht. Përveç kësaj, dokumenti autentik do të kishte edhe një varg shenjash dalluese të një marrëveshjeje ndërmjet dy palëve, duke filluar me ballinën e dokumentit dhe duke përfunduar me emrat e autoriteteve përfaqësuese ku do të duhej të figuronte dhe nënshkrimi përkatës. Po kështu, një pjesë e “titullit” është veçuar me germa të mëdha: ESTRATTO dhe PRESIDENTE PACHICH, por ama as që ai është një “estratto” autentike dhe as që Nikolla Pashiqi në atë kohë ka qenë “il presidente”.

Shkresa në fjalë tashmë është botuar edhe në një përmbledhje dokumentesh për çështjen e Shën Naumit (2012)¹⁴. Është interesant që përgatitësja e kësaj përmbledhjeje, nuk e ka parë të nevojshme që të shpjegojë përse shkresa që mban datën 9 janar 1925¹⁵, burim ky që vetë ajo e radhit në mesin e dokumenteve të këtij viti¹⁶, nga historianët lexohet si e një viti më vonë. Ç’është krejt e çuditshme dhe nga vetë ajo, kjo shkresë “lexohet” si dokument i datës 9 janar 1926¹⁷. Në vend të kësaj,

¹⁴ Kaliopi Naska, *Shën Naumi dhe Diplomacia e Kohës*, Tiranë: Kristalina-KH, 2012.

¹⁵ Shkresa përcjellëse e T. Asseretit, e jo T. Anereti siç evidencohet në këtë përmbledhje.

¹⁶ *Po aty*, referenca 1, f. 553.

¹⁷ Fjala është tek përmbajtja e tij. Edhe pse në dokumentin përcjellës të gjashtëmbëdhjetë pikëshit të dërguar në Romë nga T. Assereti evidencohet data 9 janar 1925, përmbajtja e kësaj shkrese na flet se sa i përket vitit duhet të jetë lapsus i bërë nga i ngarkuari me punë italian në Shqipëri. Prandaj dhe Dosja 105 e Fondit 251 është sistemuar brenda dosjeve që ruajnë dokumente të vitit 1925 e jo në dosjet e vitit

redaktorja në një fusnotë njëfaqësh “fuqizon” idenë e autenticitetit të dokumentit dhe “Marrëveshjes Zogu-Pashiq”¹⁸ duke iu referuar disa autorëve. Dhe ç’është më keq fjala italishte *autorevole* që ka kuptimin person “i autoritetshëm” përkthehet si person “i autorizuar”¹⁹. Në këtë rast del sikur dokumenti është servirur nga ndonjë autoritet zyrtar i cili mund të jetë: ministër fuqiplotë, ministër i jashtëm etj. Ndërkaq, fjala i autoritetshëm mund të nënkuptojë edhe një afarist, një shkrimtar, një gazetar, etj. Pra në kontekstin e dhënë kemi të bëjmë me një kuptim rrënjësisht të ndryshëm. Çështja është, a kemi të bëjmë me një lapsus të përkthyesit apo kjo është bërë me qëllim dhe në funksion të fuqizimit të qëndrueshmërisë së burimit.

Në Shqipëri, “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi” i përcjellë me një analizë të hollësishme për herë të parë u publikua në vitin 1986, nga studiuesi Marenglen Verli me titull “Rreth një marrëveshje antikombëtare”²⁰. Duke komentuar pikën e parë dhe të dytë të këtij “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi”, Verli nxjerr përfundimin se “... kjo marrëveshje çonte në humbjen e pavarësisë dhe e kthente Shqipërinë në një provincë të Jugosllavisë me një autonomi shumë të kufizuar, kurse A. Zogu siguronte për vete administrimin e brendshëm të saj”²¹. Por duhet cekur se përkundër faktit që ky autor beson në këtë përmbajtje, nuk e lë pa cekur se Pastoreli “... duke u nisur nga disa detaje që kanë të bëjnë me mënyrën e zbulimit të marrëveshjes, me mënyrën e formulimit të klauzolave të saj dhe me vlerën e diskutueshme juridike, e konsideron të dyshimtë ekzistencën e marrëveshjes, të paktën sipas variantit që njeh”²². Po kështu, ky studiues përkundër rezervave ndaj korrektësisë profesionale të autorit jugosllav Zhivko Avramovski, megjithatë evidencon në mënyrë të përpiktë se ky autor pohon se nga bisedimet ndërmjet Zogut dhe qeverisë jugosllave “nuk ekziston kurrfarë dokumenti i shkruar”²³.

1926. Më parë kjo përmbajtje arkivore ka qenë e sistemuar brenda dokumentacionit të vitit 1924.

¹⁸ K. Naska, *Shën Naumi dhe diplomacia ...*, f. 558.

¹⁹ *Po aty*, f. 553.

²⁰ Marenglen Verli, “Rreth një marrëveshje antikombëtare të Ahmet Zogut”, *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1986.

²¹ Marenglen Verli, “Rreth një marrëveshjeje të A. Zogut të vitit 1924”, në *Kosova në fokusin e historisë*, Tiranë: Botimpex, 2002, f. 182.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*.

Kurse historiani Kristo Frashëri, çështjen e “Marrëveshjes Zogu-Pashiq” e trajton në librin e tij “Ahmet Zogu - Vështrim historik” (2014), libër të cilin e konsideron si kontribut në debatin “që po zhvillohet këto kohët e fundit rreth Ahmet Zogut...”²⁴. Pa hyrë në aspekte të tjera të këtij libri, po ndalemi në titullin “Marrëveshja e Ahmet Zogut me Pashiqin dhe kundërrevolucionin zogist”. Autori në fjalë pa asnjë hezitim konstaton se: “Për të rimarrë pushtetin në Shqipëri, ai (Zogu- E. B.) u tregua i gatshëm të pranonte *pa asnjë rezervë*²⁵ të gjitha kushtet që i diktoi kryeministri i qeverisë jugosllave N. Pashiqi. Kështu më 14 gusht 1924, A. Zogu nënshkroi në Beograd me Nikolla Pashiqin një marrëveshje të fshehtë, të përbërë nga 16 pika, njëra më e zezë se tjetra”²⁶. Pasi autori potencon “faktin” se përkundër Nikolla Pashiqit që “*ishte kryetar qeverie (!)*” kurse “Zogu nuk ishte”, nis me komentimin e “*neneve*” të “*këtij akti*”²⁷. Risi “*faktike*” dhe fuqizuese për “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshin” në këtë trajtim është evidencimi i datës së nënshkrimit të tij, e që sipas këtij autori është “14 gushti”. Edhe pse 14 gushti shndërrohet në refren megjithatë kjo datë nuk përmendet në asnjë shkrim që ka të bëjë me këtë çështje, cilido qoftë ai, e që ky autor e shfrytëzon dhe e evidencion. Madje, kjo datë nuk evidencohet as në shkrimin të cilit i referohet dendur dhe pa asnjë rezervë Frashëri, e ky është “E vërteta e Marrëveshjes Zogu-Pashiq”²⁸, me autor Ksenofon Krisafi. Analiza e një dokumenti *autentik*, të nënshkruar, në datë të caktuar nga aktorë të definuar me një përmbajtje të tillë, natyrisht që autorit Frashëri i jep të drejtë që të jap verdiktin historik për nënshkruesin shqiptar: Ahmet Zogolli tradhtar bir tradhtari, i cili për pushtet dhe dinasti²⁹ e shet dhe vetë shtetin.

²⁴ K. Frashëri, *Ahmet Zogu ...* .

²⁵ Është interesant fraza “*pa asnjë rezervë*”. Po nëse megjithatë Zogu të ketë shprehur ndonjë rezervë...

²⁶ K. Frashëri, *Ahmet Zogu ...*, f. 63. “Me premtimet për ndihmë që mori nga kryeministri (!) serb Nikolla Pashiçi, sapo në fillim të gushtit (!) 1924 arriti në Beograd ai (Zogu) deklaroi se *po përgatitej të rivendoste* në Shqipëri statusin ligjor(!) të përmbysur nga kryengritësit (!) ...”. Në fillim të gushtit as Nikolla Pashiqi ishte kryeministër e as që Zogu sapo arriti në Beograd. Po kështu Zogu ka qenë shumë i matur me deklarata dhe zakonisht ka folur për paqëndrueshmërinë e qeverisë së Fan Nolit, dhe rënien e saj të shpejtë.

²⁷ *Po aty*, f. 66.

²⁸ Ksenofon Krisafi, *Gazeta Tema*, 13 shtator 2012.

²⁹ Ahmet Zogu shumë i vetëdijshëm për atentatet që i përgatiteshin nga të katër anët nuk nxitonte të martohej për të krijuar dinasti. Ai është martuar në vitin 1938. Në fakt tri

Ndërkaq, profesori i të Drejtës Ndërkombëtare³⁰ Ksenofon Krisafi, në punimin e përmendur për të “vërtetën e Marrëveshjes Zogu-Pashiq”, konstaton se “Nga një lexim i *shpejtë* i tekstit rezulton se marrëveshja është një *akt zyrtar kapitullimi i turpshëm për shtetin shqiptar*, krejtësisht i pamotivuar dhe juridikisht i pajustificuar...” (!!!). Dhe në vazhden e analizës lidhur me arsyet përse kjo marrëveshje nuk u jetësua në tërësi, ky autor arsyeton: “ai që e *negocioi* dhe që e *firmosi* atë nuk kishte asnjë mandat legal, asnjë plotfuqi zyrtarë të lëshuar nga autoritetet kompetente shqiptare. Ahmet Zogu ishte thjeshtë një shtetas shqiptar i arratisur jashtë vendit, një ish kryeministër i rrëzuar nga pushteti nëpërmjet një *kryengritje...*”. Për hir të së vërtetës, Ahmet Zogu kishte dhënë dorëheqje nga posti i kryeministrit menjëherë pas atentatit kundër tij në ambientin e parlamentit (shkurt 1924), shumë kohë para se të ndodhë kryengritja. Këtij autori i hyn në punë dhe Kosova ku në një të përmuajshme të saj, “marrëveshja” në fjalë ishte botuar e plotë³¹, por nuk e thotë se në fakt autori i këtij artikulli është nga Tirana. Po kështu një autori nga Kosova³², i atribuon pohimin se ai “e ka gjetur tekstin origjinal të marrëveshjes në Arkivin Qendror të Shtetit, në Fondin 251, në Dosjen 105, të vitit 1924”. Për hir të së vërtetës, autori kosovar nuk e pohon këtë gjetje. Ai, lidhur me “Marrëveshjen Zogu-Pashiq” riprodhon besnikërisht përmbajtjen nga një studim i mëhershëm³³ dhe aprovon pa asnjë rezervë këtë përmbajtje me ç’rast edhe ky radhitet ndër ithtarët e “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit”. Krisafi, “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshin” e vendos në kontekstin e dëshmimeve të tradhtive të mëdha kombëtare shqiptare aktuale dhe historike.

Në vitin 2008, është botuar dhe një libërth lidhur me Çështjen e Shën Naumit³⁴ nga Monika Shoshori-Stafa, në të cilin, “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi” është subjekt tepër i rëndësishëm, krejt i besueshëm, plotësisht

martesa të familjes Zogu, e dy motrave të Zogut dhe vetë akti i martesës së tij para së gjithash kanë pasur karakter politik-shtetëror.

³⁰ Në Universitetin Evropian të Tiranës.

³¹ Marenglen Verli, “Marrëveshjet e E. Toptanit dhe A. Zogut me N. Pashiqin”, *Albanica*, 5/2007.

³² Faton Mehmetaj, *Vepimetaria kriminale e “Dorës së Zezë” serbe në trojet shqiptare*, Prishtinë: 2004.

³³ *Po aty*, f. 207. Ky autor i referohet studimit të Paskal Milos, *Shqipëria dhe Jugosllavia (1918-1927)*, Tiranë: Shtëpia botuese Enciklopedike, 1992.

³⁴ Monika Stafa-Shoshori, *Çështja e Shën Naumit, Studim historiografik dokumentues*, Tiranë: Albas, 2008.

autentik, por ama çalon “kronografia”³⁵: herë gusht e herë korrik, herë viti 1924 e herë ai 1925³⁶. Kjo autore “tekstin e Marrëveshjes Zogu-Pashiq” e përkufizon si “metatekst” në dy variante, njëri në Itali që është botuar dhe tjetri në Shqipëri, “dhe nuk është botuar ndonjëherë i plotë”³⁷. Në fakt nuk kemi të bëjmë me dy variante, po me një variant përmbajtjeje në dy letra. Po kështu, ky tekst siç u pa, në Shqipëri është botuar i plotë në vitin 1986 (Verli), po dhe në vitin 1992 (Milo), në monografinë që autorja në fjalë e ka shfrytëzuar jo pak. Autorja e re dhe shumë ambicioze nuk kënaqet me ballafaqimin me një punim të një autori jugosllav të botuar në shqip në vitin 1968, në të cilin ai bën fjalë për një “lloj “marrëveshje xhentëlmene”” midis Zogut dhe *qeverisë jugosllave* e jo N. Pashiqit, siç pohon ajo, dhe me konstatimin e tij se “marrëveshje me shkrim nuk ka pasur”, por përkufizon një mbase meta-entitet dhe konstaton se “shkolla e historiografisë serbe e ka përgënjeshtuar ekzistencën e një marrëveshjeje me shkrim dhe pretendon se ekziston vetëm një “gentilman agreement”³⁸ !!! . Sipas kësaj autoreje, kjo shkollë “metadokumentin” e marrëveshjes e ka shpallur të paqenë “për shkak të interesave joshkencore”³⁹. Për të vazhduar me këtë përkufizim: “Fakti që përmbajtja e saj është cituar *saktësisht* në studimet e *historianëve serbë* lejon të kuptohet se *originali duhet të ruhet* dhe nuk ka ndonjë dallim të madh me variantin e shërbyer nga shkenca historiografike italiane. Në *thelb*, P. Pastoreli dhe Zh. Avramovski *pajtohen* për premtimet e marrëveshjes, vetëm se njëri i referohet një teksti (metateksti), kurse tjetri komenteve dhe burimeve dytësore”⁴⁰.

Mund të thuhet se studiueses së re i mungon plotësisht korrektësia dhe saktësia në konstatimet e sipërshënuara. Nuk bëhet fjalë për shumë autorë serbë, aq më pak për ndonjë “shkollë historiografike serbe” që u mor me këtë çështje, as për ndonjë pretendim, kontestim ose pajtim midis autorësh, e as për interesa joshkencorë. Autorja bën gabim të madh kur

³⁵ *Po aty*, f. 13.

³⁶ *Po aty*, f. 11: gusht 1925, f. 24: gusht 1924; f. 25: korrik 1924; f. 26: gusht 1925 etj; mandej f. 35: “teksti i marrëveshjes nga atasheu ushtarak Praska u raportua në gjysmën e nëntorit 1926 (!); dhe më pas i njëjti tekst qeverisë italiane iu raportua nga atasheu ushtarak(!) në Tiranë T. Assareto...”; f. 12: “... një akt tradhtie i ish-mbretit Zog (1924-!); f. 14: “ish mbreti i ardhshëm...”; e kështu në pafundësi....

³⁷ *Po aty*, f. 6.

³⁸ M. Stafa-Shoshori, *Çështja e Shën Naumit ...*, f. 7.

³⁹ *Po aty*, f. 9.

⁴⁰ *Po aty*, f. 7.

historianin Avramovski e fut në një kontekst negativ me të cilin ai s'ka të bëjë as si profil shkencor e as si përkatësi etnike. Sikur M. Stafa të kishte lexuar ndonjë studim të këtij autori, ose të paktën të kishte lexuar në mënyrë integrale qoftë dhe punimin të cilit i referohet, do të mësonte shumë prej tij. Një libër i vockël me gabime të shumta dhe të mëdha.

Një ndër studiuesit shqiptarë që me studimet e tij, ka mbuluar dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave të kësaj periudhe është historiani dhe politikani Paskal Milo. Edhe ai ndalet në çështjen e "marrëveshjes" në fjalë. Në studimin e tij *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*(1992) shpreh mendimin se "Marrëveshja është autentike"⁴¹ dhe se "Versioni që paraqet Zh. Avramovski është i përmbledhur, ai nuk riprodhon as edhe atë çka është thënë integralisht në elaboratin e nëpunësit të Ministrisë së Jashtme jugosllave. Pra teksti i marrëveshjes midis Zogut e Pashiqit, duke kaluar përmes dy sitave, ka arritur të botohej jo i plotë ...".⁴² Pasi ky autor konstaton se varianti i dokumentit të marrëveshjes të siguruar nga diplomacia italiane, "shënonte programin më të avancuar të politikës jugosllave ndaj Shqipërisë"⁴³, pohon se "... në thelb edhe versioni i Zh. Avramovskit është pothuajse i njëjtë me atë që gjendet në arkivin tonë dhe me atë që ka shfrytëzuar Pastoreli"⁴⁴. (!!!).

Ndërkaq në studimin voluminoz (2013) që ka të bëjë me politikën e jashtme të shtetit shqiptar që nga themelimi e deri te pushtimi italian⁴⁵, Milo konstaton se Zogu i ndodhur midis dilemës për *dy rrugë të mundshme*, atë "të dajës së vet, Esat Pashë Toptanit, të arrinte marrëveshje me kosto të madhe kombëtare si çmim për t'u kthyer në pushtet, ose të mbetej një emigrant e azilant politik në Jugosllavi apo gjetiu tjetër. Vendosi e zgjodhi rrugën e parë"⁴⁶. Por në vazhdim të këtij mendimi autorit i paraqitet edhe *rruga e tretë* për Zogun, e kjo ishte mundësia e një marrëveshje me Italinë. Sipas këtij autori, Zogu refuzoi që kërkesat e tij t'i parashtronte në një letër personale drejtuar Musolinit

⁴¹ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia ...*, f 300.

⁴² *Po aty*, f. 303.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *Po aty*, f. 301.

⁴⁵ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2013, f. 656-657.

⁴⁶ *Po aty*, f. 657.

përkundër faktit që ky i garantonte sekret të plotë, sepse “*ishte aq i zgjuar sa të refuzonte çfarëdo lloj dëshmie me shkrim*”⁴⁷.

Në këto studime, P. Milo thëllon analizën dhe zhvillon teorinë se po ta kishte një dokument të tillë Beogradi do “ta nxirrte në dritë”⁴⁸ në kohën kur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u “acaruan në kulm” (1926-1927), gjë që nuk ndodhi. Kështu që ky historian çështjen e dokumentit dokumentues për tradhtinë e Ahmet Zogut e zgjidh përmes një kompromisi që ka për produkt një hibrid fiktiv për këtë “marrëveshje”: “*Marrëveshje xhentëlmënësh*” *Zogu-Pashiq me 16 pika*”⁴⁹.

Në librin e fundit të Milos (2013) ka dhe një risi: Në faqen 657 në fusnotën 2 pohohet se Dokument-marrëveshja Zogu-Pashiq, gjendet në tre Arkiva, ndër ta dhe atë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë⁵⁰. Dhe ky konstatim e çimenton të vërtetën, apo jo? Por çështja është a ekziston një arkiv i tillë? Nëse është fjala për Arkivin e Serbisë (Arhiv Srbije), aty ruhet Fondi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë nga viti 1839-1918⁵¹, pra deri në vitin e “shkrirjes” së Serbisë në entitetin e ri shtetëror, Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene (SKS) përkatësisht Jugosllavinë. Që nga ky vit i gjithë materiali i kësaj sfare (të marrëdhënieve me jashtë të Mbretërisë SKS-Jugosllavisë) është arkivuar në Arkivin Diplomatik të RSFJ (Diplomatski Arhiv Saveznog Sekretariata Inostranih Poslova - DAASIP), në Arkivin e Jugosllavisë (Arhiv Jugoslavije), dhe në Arkivin e Institutit Ushtarak-Historik (Arhiv Vojno-Istoriskog Instituta), të gjithë këta me seli në Beograd⁵². Pra, për cilin Arkiv të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë bëhet fjalë?

⁴⁷ *Po aty*. Paskal Milo konstaton se Beogradi e njihte mirë “*ambicien e shfrenuar për pushtet dhe etjen e tij për para por edhe dinakërinë e gjakftohtësinë për të bërë pazare e për të mos e mbajtur fjalën...*”!!!. I shkreti Beograd me çfarë njeriu pati punë.

⁴⁸ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia ...*, f. 298; Nëse Miloja mendon se Beogradi do t’ia përkujtonte këtë çështje Zogut në situata krize në raportet Tiranë-Beograd në “katër sy”, pajtohem plotësisht. Por nëse Miloja mendon se Beogradi do ta nxirrte në opinion këtë “marrëveshje” atëherë nuk pajtohem aspak, sepse kjo do të komprometonte vetë Beogradin në arenën ndërkombëtare ...

⁴⁹ P. Milo, *Politika e jashtme ...*, f. 657.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ Për këtë shih në *Arhivski fondovi i zbirke u SFRJ-SR Srbija*, Beograd: 1978, f. 35.

⁵² Në këto arkiva (DASSIP dhe AJ) janë ruajtur dhe fondet personale të politikanëve serbë të cilët kanë vazhduar veprimtarinë politike edhe ndërmjet dy Luftërave Botërore.

Në mënyrë që mos të lihet asnjë dyshim për autenticitetin dhe vërtetësinë e “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit”, Milo i rreket metodës krahasuese dhe konstaton se kjo marrëveshje “ishte në modelin e marrëveshjeve të nënshkruara nga Esat Pashë Toptani në shtator 1914 me vetë Pashiqin e në maj 1915 me ministrin e Brendshëm të Serbisë”⁵³. Kështu i bie që palët dhe synimet janë të njëjta me një ndryshim shumë të vogël: atëherë ishte daja e në rastin “tonë” nipi. Gjaku nuk është ujë. Apo të shprehemi me një trendi terminologji: Orientimi politik gjendet në ADN e njeriut. Burra të një gjaku, të një proveniencë fetare, rajonale, shoqërore: Paketimi i Dajës dhe Nipit, një matematikë shumë e preferuar për të vërtetuar.

Milo ka pasur në dispozicion një studim i cili figuron në bibliografinë e studimeve të tij (1992, 2013), të historianes serbe Desanka Todorović⁵⁴. Aty bëhet fjalë për planet ambicioze që ministri i jashtëm jugosllav M. Ninçiq po bënte lidhur me Shqipërinë në kohën kur marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave shënojnë kulmin e afrimit dhe bashkëpunimit, në vitin 1923. Jugosllavia pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Paris (nëntor 1921) për Shqipërinë, e pranoi dhe lidhi raporte diplomatike me të në vitin 1922. Ndërkaq përcaktimi i zëshëm i diplomacisë së saj për pavarësinë e Shqipërisë kishte të bëjë me frikën e depërtimit italian pasi që ripohimi i pavarësisë së Shqipërisë në këtë Konferencë⁵⁵, u shoqërua me pranimin e një lloj kujdestarie të ndërmjetësuar të Italisë ndaj këtij shteti. Në këtë studim të autores serbe,

⁵³ *Po aty*, f. 657; *Shqipëria dhe Jugosllavia ...*, f. 303; Fjala është për dy “marrëveshje” të Esat Pashës të gjetura nga historiani Shukri Rahimi hulumtues i zellshëm i Arkivit të Serbisë, dhe të publikuara në *Gjurmime Albanologjike* VI, Prishtinë: 1977; të ribotuara në *Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë 1986 f. 291-319. Por në këto dy dokumente evidencohet vetëm emri i Esatit. Në të parin në fund të dokumentit evidencohet: Në Nish, më 4 shtator 1914 (majtas), Në emër të Shqipërisë dhe popullit shqiptar Esat Toptani (djathtas) dhe mungon emri i Nikolla Pashiqit. Në fund të dokumentit të dytë evidencohet: Më 15 (28) qershor 1915(majtas) dhe Kryetari i qeverisë Esat Pasha (djathtas) dhe mungon emri i ministrit të Brendshëm serb. Me një fjalë, edhe sikur “pala shqiptare” të pajtohej me diçka të tillë pala serbe nuk do të vinte nënshkrimin e saj në një marrëveshje komprometuese në arenën ndërkombëtare dhe në sy të aleatëve të saj, as atëherë në kushte të luftës e lëre më këtë herë (1924).

⁵⁴ Desanka Todorović, *Jugosllavija i balkanske države 1918-1923*, Beograd, 1979.

⁵⁵ Për këtë shih te studiuesi Arben Puto, “Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve në vitet 1920-1921”, *Studime historike*, 3, Tiranë: 1965; po ai, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë: Toena, 2009, f. 283- 300.

evidencohet dëshira e palës shqiptare për një marrëveshje ekonomiko-tregtare dhe synimet e palës jugosllave që me Shqipërinë të lidhë një marrëveshje për union doganor dhe që ky propozim ishte refuzuar nga kryeministri Zogu dhe ministri i jashtëm shqiptar i asaj kohe⁵⁶.

Po ashtu, sipas kësaj autoreje, ministri i Jashtëm jugosllav, Ninçiqi (në qeverinë e Pashiqit) në vitin 1923 i propozoi kryeministrit shqiptar A. Zogu, një marrëveshje të fshehtë me këtë përmbajtje: “Marrëveshja përfundimtare me Bajram Currin dhe Hasan Prishtinën”, sigurisht në kuptimin që ata të heqin dorë nga aktiviteti i tyre irredentist; “Largimi i komitëve bullgarë dhe përkrahësve të Komitetit Maqedonas”, të cilët sipas informacioneve jugosllave po gjenin strehim sidomos në fshatrat bullgare-maqedonase në rrethin e Korçës; “Kthimi i të ikurve mirditas të cilët kishin gjetur strehim në Jugosllavi”, pasi ishin përfshirë në lëvizjen separatiste të verës së vitit 1921; si dhe një mbështetje politiko-ekonomike të Shqipërisë në Jugosllavi, në të vërtetë që pa miratimin e qeverisë jugosllave mos të bëheshin koncesione për kompanitë e huaja⁵⁷ e që në fakt kishte të bënte me frikën e Beogradit për depërtim ekonomik të Italisë në Shqipëri. Pra siç po shihet, ky propozim i Ninçiqit sado ambicioz, ishte larg përmbajtjes që figuron në “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshin” e një viti më vonë. Po kështu, kjo autore na jep një të dhënë interesante dhe domethënëse lidhur me faktin se në vitin 1921, kur kreu i Mirditës kishte kapur flamurin separatist dhe një forcë e tij e ndihmuar nga forcat e armatosura jugosllave po e sulmonte Matin dhe po u vente zjarr shtëpive të parisë nuk e anashkaluan as kompleksin e banimit të A Zogut. Por, para se t’ia venin zjarrin i vodhën Arkivin familjar⁵⁸. A i bëhet kjo një miku? Por pasi që “Republika e Mirditës” ishte tentim shturjeje të Shqipërisë, krejt e natyrshme që në këtë rast Zogu nga mik shndërrohej në armik.

⁵⁶ Po aty, f. 142.

⁵⁷ DASSIP, C. Marković, Otkup, III, pismo Ninčiću bez datuma.

⁵⁸ D. Todorović, *Jugoslavija i balkanske ...*, f. 137.

Cili është identiteti i burimit të cilit i referohet historiani jugosllav Zhivko Avramovski, lidhur me një "lloj "marrëveshje xhentëlmenësh"', ndërmjet qeverisë jugosllave dhe A. Zogut dhe çka përmban ai?

A është ky një material i përgatitur nga një nëpunës i Ministrisë së Punëve të Jashtme Jugosllave për nevoja të punës së përditshme në atë kohë (1924)⁵⁹, apo i një kohe krejt tjetër; sa qëndron pohimi se Avramovski "nuk riprodhon as edhe atë çka është thënë integralisht në elaboratin e nëpunësit të Ministrisë së Jashtme jugosllave", dhe, së fundi sa qëndron konstatimi se ky burim ka përmbajtje në *thelb të njëjtë* me "Gjashtëmbëdhjetë Pikëshin", siç e pohojnë njëzëri ithtarët e këtij të fundit?

I.

Studiuesi jugosllav Avramovski në punimin e tij që ka të bëjë me marrëdhëniet jugosllave-shqiptare 1918-1939⁶⁰, të botuar në shqip (1968) në një revistë shkencore në Kosovë (*Gjurmime Albanologjike*) por dhe unë në një punim⁶¹ të botuar po në këtë revistë disa vite më vonë (1981), nuk përmendim kurrfarë *dokumenti* dhe as *tandemi* Zogu-Pashiq. Avramovski si dhe unë i referohemi të njëjtit burim: një elaborati shumëfaqësh me titull: "Shqipëria në periudhën midis dy luftërave" që mban datën 11 maj 1952⁶², të përpiluar nga një ish nëpunës i cili ka shërbyer në Sektorin Ballkanik të Mistrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene-Jugosllavisë, dhe që është arkivuar në Arkivin e Institutit Ushtarak-Historik (AVII) në Beograd. Avramovski me të drejtë konstaton se në këtë elaborat ka edhe gjëra të paqëndrueshme. Kjo nga se, siç e thotë vetë ish nëpunësi diplomatik jugosllav, këtë elaborat e ka punuar në bazë të kujtimeve sepse dokumentacionin *tepër sekret* të Sektorit Ballkanik, ku ai ka punuar, dhe

⁵⁹ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia ...*, f. 301. "Zakonisht studimet për nevojat e punës së përditshme nuk ishin të gjata dhe në to jepeshin drejtimet dhe faktet kryesore. Shembull në këtë drejtim janë elaboratet e I. Vukotiçit dhe I. Andriçit ...".

⁶⁰ Zhivko Avramovski, "Kontribut studimit të historisë së Shqipërisë në periodën midis dy luftërave botërore", *Gjurmime Albanologjike*, 2, Prishtinë: 1968.

⁶¹ Emine Arifi-Bakalli, "Qeveria demokratike e Fan Nolit dhe qëndrimi i Mbretërisë SKS ndaj saj", *Gjurmime Albanologjike*, XI, Prishtinë: 1981.

⁶² *Arhiv Vojno-Istoriskog Instituta* (më tej: AVII), (Popisnik) P-17, k-61g, f. 1, d. 14.

pra materiali i Sektorit Shqiptar (Albansko Odelenje) është asgjësuar nga dora e tij në vitin 1940⁶³.

Para se të paraqesim përmbajtjen e pjesës të këtij Elaborati që ka të bëjë me çështjen tonë, më parë të shohim çka e shtyu këtë ish diplomat jugosllav të përgatisë këtë elaborat? Përgjigjen e gjejmë në një material-Udhëzim me titull: “Politika e jashtme e Mbretërisë së Jugosllavisë” të përgatitur në vitin 1951,⁶⁴ i cili ruhet në Arkivin e Institutit Ushtarak-Historik në Beograd. Pushteti i atëhershëm jugosllav shtron detyrën për një analizë të politikës së jashtme të ish Jugosllavisë dhe për rolin e kreatorëve kryesorë të kësaj politike, siç ishte Nikolla Pashiqi, Mbreti Aleksandër, Vojislav Marinkoviç, Momçillo Ninçiqi, Jovan Jovanoviç etj. Në të njëjtën kohë jepen dhe sugjerimet për përkufizimin e karakterit të kësaj politike duke potencuar se “... ndriçimi i këtyre çështjeve patjetër duhet të sjellë deri te këto rezultate të pakontestueshme ...: Ish Jugosllavia nuk ka zhvilluar politikë të jashtme të pavarur, të vendosur, parimore e konsistente duke mbrojtur interesat e vërtetë të shtetit dhe popullit” sepse diplomatët e saj “nuk kanë ditur, nuk kanë dashur, nuk kanë mundur, dhe përgjithësisht nuk kanë qenë të arrirë për një politikë të vërtetë parimore të stilit të lartë”. Në rast se ka pasur përpjekje që të zhvillohet një politikë e pavarur, “e gjitha ka përfunduar në intriga dhe ngatërresa rrëmihëse në vendet fqinje”. Dhe pikërisht në këtë kuadër futet dhe “afëra me Ahmet Zogun” si dhe përgatitja e grushtshtetit në Bullgari, etj”⁶⁵. Që do të thotë se personi që do të përgatiste këtë “studim”, do të duhej që çështjen ta paraqiste sa më komprometuese si për Jugosllavinë po ashtu dhe për Zogun. Po kështu sugjerohej që pikë orientuese për vlerësimin e natyrës së kësaj politike të ish Jugosllavisë të merrej vepra e socialistit serb të shekullit XIX, Svetozar Markoviç⁶⁶.

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *AVII*, P-17, Reg. Br. 38/1-1, D. 610. Dokumenti-Udhëzimi është shkruar me alfabetin latin dhe në cepin e djathtë evidencohet me shkrim dore: prof. Agapov, ndërsa në cepin e majtë të materialit evidencohet: pisano (shkruar) 1951 g. Në fakt ky udhëzim ka të bëjë vetëm me raportet e ish Jugosllavisë me Italinë, me Vatikanin dhe me Shqipërinë.

⁶⁵ *AVII*, nr. regj. 38/1-1, D. 610; *Spoljna politika Kraljevine Jugoslavije*.

⁶⁶ Svetozar Markoviç, *Sabrani Spisi, I*, Kultura, Beograd 1969, f. 102; Ky socialist serb i shek. XIX, ka qenë ndër kritikët më të rreptë të politikave ekspansioniste serbe të asaj kohe dhe ka spikatur shfrytëzimin material dhe kulturor të shtresave të gjera të shoqërisë serbe për politikën pushtuese të Serbisë. Në njërin ndër shkrimet e shumta të

Nën pikën tre të këtij materiali-udhëzues evidencohet titulli: "Mbretëria e Jugosllavisë dhe Shqipëria"⁶⁷. Në këtë kuadër sugjerohej që personi i cili do të merrte përsipër që të trajtonte këtë çështje do të duhej të shkoqiste këto aspekte: synimet e shteteve fqinje ndaj Shqipërisë; rrjedhat kryesore politike po dhe kishtare në Shqipëri; rolin e politikanëve serbë në këtë mes e sidomos atë të Nikolla Pashiqit dhe natyrisht roli i Zogut në rrjedhat politike të Shqipërisë dhe orientimi i tij i jashtëm. Bien në sy interesimi i madh për Zogun dhe rolin e tij në rrjedhat e brendshme politike. Në rubrikën *Vërejtje* jepen dhe udhëzimet për burimet arkivore po dhe ato gojore si dhe konstatimi se personi që mund të përgatiste këtë analizë "më parë do të gjendej në mesin e

tij, theksonte se çdo fëmijë në Serbi e di që "Serbia e Madhe" do të thotë "hakmarrja për Kosovën, kthimi i trashëgimisë të car Dushanit"⁶⁶.

⁶⁷ *AVII*, nr. regj. 38/1-1, D. 610; Teksti original nën këtë titull: "III: Mbretëria e Jugosllavisë dhe Shqipëria"

1. Shqipëria dhe aspiratat e fqinjëve. Politika e Italisë dhe qëndrimi i politikanëve jugosllavë e sidomos politikanëve serbë (të krahasohet me këndvështrimin e Svetozar Markoviqit).
2. Zogu dhe rrethanat në Shqipëri pas Luftës së Parë Botërore. Partitë politike, ndasia fisnore, ndasia fisnore, kontradiktat fetare, ndikimi i Fuqive të Mëdha, gjurmët e sundimit turk dhe mbeturinat e feudalizmit, prapambetja dhe amullia si karakteristika specifike të malësorëve shqiptarë (shiptarskih), Vilhelm Widi (1913-1914) dhe mossuksesi i tij. Zogu si komandant i forcave vullnetare shqiptare në shërbim të Austrisë, si ministër (në vitin 1920), si kryeministër (në vitin 1922) dhe kryetar republike (në vitin 1925). Në kë dhe në çka është mbështetur Zogu? Ku dhe nga kush ka kërkuar përkrahje.
3. Qëndrimi i politikanëve jugosllavë ndaj Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj politikë, përkatësisht ndaj prijësve të ndryshëm fisnorë, fetarë dhe kategorive tjera. Këndvështrimi i Nikolla Pashiqit dhe qëllimet e politikës së tij ndaj Shqipërisë: 1/ Parandalimi i shndërrimit të Shqipërisë në satelit të Italisë; 2/ Paralizimi i ndikimit të Italisë në Malin e Zi; 3/ Të përfundohej rrëtimi i irredentës shqiptare në Kosovë (duke e lënë pa përkrahjen e Shqipërisë).
4. Hapat e N. Pashiqit në drejtim të realizimit të synimeve të kësaj politike; 1/ Identifikimi-kërkimi i miqve në Shqipëri; Shugurimi i episkopit ortodoks shqiptar (Visarion Xhuvanit), qëndrimi i Sinodit të Shenjtë të Kishës ortodokse serbe. Roli i mitropolitit rus Antonije (ep. Ganrilija dhe Mitrofana?), protestimi i ministrit fuqiplotë italian; 3/ Përkrahja Ahmet Zogut për synimet e tij që të bëhet mbret i Shqipërisë. Realizimi i këtij hapi pas vdekjes së N. Pashiqit. Roli i F. Mahina.

Vërejtje: 1. Burimet: Arkivi i Sektorit Ballkanik të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Arkivi i Sinodit, Arkivi i "Udhëheqjes episkopate" ruse, të dhënat për dotacionet nga fondi dispozicional (nëse ekzistojnë fare). Sa i përket këndvështrimeve të N. Pashiqit do të mund të informonte diçka M. Dimitrijeviç. Për rolin e mitropolitit Antonije ndoshta di diçka Profesori i Fakultetit Teologjik Fradinski; 2. Është vështirë të identifikohet personaliteti, i cili do të ishte i përshtatshëm për trajtimin e kësaj teme dhe më parë do të gjendej në mesin e diplomatëve, se sa ndër historianë dhe politikanë (kurse nga diplomatët duhen marrë në konsiderim ata të cilët kanë punuar në Sektorin Ballkanik të Ministrisë së Punëve të Jashtme".

diplomatëve se sa në mesin e historianëve dhe të politikanëve”, ndërsa “nga diplomatët vijnë në konsiderim ata që kanë punuar në Sektorin Ballkanik të Ministrisë të Punëve të Jashtme”⁶⁸, thuhej në këtë material.

Pikërisht njëri ndër këta ish diplomatë të këtij sektori u angazhua që ta përgatis elaboratin e përmendur dhe të shfrytëzuar nga Avramovski po dhe nga unë. Ndërkaq studiuesi dhe hulumtuesi tjetër i fondeve arkivore jugosllave për periudhën ndërmjet dy Luftërave Botërore⁶⁹ dhe autori i disa punimeve që kanë të bëjnë me Shqipërinë, Vuk Vinaver nuk e ka pasur në dorë këtë elaborat. Prandaj ky autor në një punim për këtë periudhë kufizohet vetëm në informacionin për një takim të Zogut me Ninçiqin (para se të largohej nga posti i ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë SKS) dhe në konstatimin se ministri i ri i Punëve të Jashtme jugosllav Marinković e përkrahu atë⁷⁰.

II.

Le t’i kthehemi Elaboratit të përmendur dhe pjesës së tij që ka të bëjë me çështjen tonë⁷¹. Pasi, në faqen 6 (gjashtë) të këtij elaborati

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ Vuk Vinaver ndër të tjera ka qenë i fokusuar në studimin e marrëdhënieve jugosllavo-hungareze ndërmjet dy Luftërave Botërore.

⁷⁰ Vuk Vinaver, “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore”, *Gjurmime Albanologjike*, 1, Prishtinë: 1968, f. 201.

⁷¹ *AVII*, P-17, k-61g, f. 1, d.14; Pjesa e Elaboratit që ka të bëjë me çështjen e “premtimeve me gojë” të Ahmet Zogut në origjinal: “Da će prihvatiti našu tezu odnosno razmimoiloženja po pitanju granica prema Ohridu. Mi se nismo mogli odreći manastira S. Nauma, i spor je bio težak sobzirom da su na albanskoj strani bili Englezi, a na našoj samo Francuzi; Da će uzeti u ponovno razmatranje pitanje Vermoških pašnjaka i prilaznih puteve. Bilo nam je stalo da okončamo taj spor koji je izazvao stalne incidente izmedjusobno ubistva izmedju Kuća i Albanaca.; Da će raspustiti Kosovski Komitet. Stim u vezi da će kaćaci koji vrše zločine na teritoriji SHS biti smatrani kao krivci iz opštega prava a ne politički krivci; Da se pitanje albanske pravoslavne crkve kao i pitanje njegovog poglavara, neće rešavati bez sporazuma sa Srpskom Patriaršijom. Tu je skrenuta pažnja na intrige Italije u pogledu unionističke crkve i njene pokušaje da ubedi neke albanske episkope u korist stvaranja albanske unijatske crkve; Da će pitanje srpske škole u Skadru i selo Vraki povolno rešiti, kao i pitanje stvaranja srpskih škola u 11 makedonskih sela kod Korče; Po pitanju trgovinskih odnosa da se što pre pristupi pregovorima za jedan trgovinski ugovor; Albanija će odmah razmotriti pitanje davaja olakšica za pogranični promet na sektoru Prizren; Vlada SHS će slično postupiti u pogledu Skadra, čije je prirodno zaledje ostalo na jugoslovenskoj strani; Albanija će dalje omogućiti stvaranje jednog novčanog zavoda u Skadru sa jugoslavenskim kapitalom; Albanska vlada neće

konstatohet se "Lidhjet e bajraktarit të Matit me Serbinë kanë qenë të kamotshme, por që nga fillimi pa asnjë sentiment dhe të bazuara ekskluzivisht në interesin e secilës palë", evidencohet se Zogu gjatë qëndrimit në Beograd, premtoi se: "do të pranojë tezën tonë (jugosllave-E.B) lidhur me divergjencat për çështjen e kufijve në drejtim të Ohrit. Ne nuk kemi mundur të heqim dorë nga Manastiri i Sh. Naumit dhe kontesti ka qenë i rëndë për faktin se në anën e shqiptarëve kanë qenë anglezët, kurse në anën tonë vetëm francezët; Që do të trajtojë sërish çështjen e kullotave të Vermoshit dhe të rrugëve drejt tyre. Ne ishim të interesuar që ta përmyllim atë kontest i cili inicionte incidente të përhershme dhe vrasje të ndërsjella midis Kuqve dhe shqiptarëve; Që të shpërndaj "Komitetin e Kosovës". Lidhur me këtë, që kaçakët që kryejnë krime në territorin e SKS do të konsiderohen si fajtor nga e drejta e përgjithshme dhe jo fajtorë politikë; Që çështja e kishës ortodokse shqiptare si dhe çështja e kreut të saj, nuk do të zgjidhet pa marrëveshje me Patrikanën Serbe. Këtu i është tërhequr vëmendja (Zogut-E. B) për intrigat e Italisë, në çështjen e kishës Uniatike dhe përpjekjet e saj për të bindur disa episkopë shqiptarë në favor të krijimit të kishës uniatike shqiptare; që çështjen e shkollës serbe në Shkodër dhe në fshatin Vrakë ta zgjidhë në mënyrë pozitive, si dhe çështjen e hapjes së shkollave serbe në 11 fshatra maqedonase të Korçës; Sa i përket marrëdhënieve tregtare që sa më parë të fillojnë bisedimet për një marrëveshje tregtare. Shqipëria menjëherë të shqyrtoj çështjen e lehtësirave për qarkullimin ndërkuftar në sektorin e Prizrenit. Qeveria e SKS ngjashëm do të veprojë sa i përket Shkodrës, rrethi natyror i së cilës ka mbetur në anën e Jugosllavisë. Më tej Shqipëria do të mundësojë formimin e një enti monetar në Shkodër me kapital jugosllav. Qeveria shqiptare nuk do të lidhë asnjë lloj marrëveshje e as hua për ndërtimin e hekurudhës pa marrëveshje paraprake me qeverinë SKS. Anijeve tregtare me flamur jugosllav do tu lejohet që të mbajnë linjën Trieste-Rijekë-Santa Marija me dy anije bartëse; Që do të favorizojë shkollimin e studentëve shqiptarë në Jugosllavi, kurse qeveria jugosllave do të ndante bursa për këta studentë. Në Beograd do të hapej një internat për ta"⁷².

zaključiti nikakav sporazum niti zajam za izgradnju železnica bez predhodnog dogovora sa vladom SHS; Trgovačkim brodovima jugoslavenske zastave dozvolice se sa svoje strane obavezno održati liniju Trst-Rijeka-Santa Marija sa dva poluteretna broda."

⁷² Po aty.

Kushdo mund ta bëjë krahasimin e kësaj pjese-përmbajtje të këtij Elaborati me atë të “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit” (referenca 8) dhe të shohë sa qëndron pohimi i ithtarëve të tij se kemi të bëjmë me përmbajtje “*në thelb të njëjta*”. Edhe sikur t’i besojmë plotësisht këtij Elaborati në të mungon çfarëdo përmbajtje që do të shpinte në eliminimin e shtetit shqiptar. Kurse po kështu mund të bëhet dhe krahasimi me atë që ka transmetuar nga ky material Avramovski⁷³ dhe të shihet sa qëndrojnë pohimet e këtyre historianëve për mungesën e korrektësinë profesionale të këtij autori në rastin konkret, në kuptimin se ku ta dimë për çfarë arsyes ky ka devijuar sa i përket etikës profesionale duke reduktuar dhe zbutur më qëllim përmbajtjen e burimit arkivor. Në fakt nuk kemi të bëjmë me asnjë gram zbutjeje. Përkundrazi, në punimin e Avramovskit hetohet terminologji decidive (e drejta, zotimi), kurse në burimin origjinal nuk ndodh kjo. Sepse, “zotimi për një çështje” dhe “marrja në shqyrtim e një çështje” nuk kanë kuptim të njëjtë. Por duhet ditur se këtu kemi të bëjmë me një përkthim dhe nuk përjashtohet se ky devijim apo sforcim terminologjik ka të bëjë me përkthyesin nga serbishtja në shqip e jo me vetë autorin.

Siç u tha më parë Avramovski ka pohuar se në arkivat jugosllavë nuk ekziston një shkresë-dokument e cila flet për një marrëveshje të Zogut me qeverinë jugosllave. Këtu nuk kemi të bëjmë me besimin e verbër të këtij autori në pohimin e autorit anonim të Elaboratit në fjalë dhe as me ndonjë prirje pozitive ndaj figurave historike si Zogu e Pashiqi, por për faktin që vetë ky studiues përgjatë hulumtimeve shumëvjeçare në arkivat jugosllavë nuk ka hasur në një burim të tillë.

Një dokument të tillë nuk ka gjetur as studiuesi tjetër i paanshëm siç është Vuk Vinaver, edhe ky hulumtues i devotshëm i fondeve të arkivave jugosllave që ruajnë burime të periudhës të ndërmjet dy Luftërave Botërore për studimet e tij që mbulojnë këtë periudhë, dhe për punimet lidhur me Shqipërinë⁷⁴.

⁷³ Zh. Avramovski, “Kontribut studimit ...”. Sa është i përpiktë në transmetimin e pjesës së Elaboratit që ka të bëjë me “një lloj “marrëveshje xhentëlmene”, shih në f. 131-132 të këtij punimi.

⁷⁴ Punimet e V. Vinaver për Shqipërinë: “Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore”, *Gjurmime Albanologjike*, 1, Prishtinë: 1968; “Fašizam i jugoslavrnsko-albanski odnosi na početku drugog svetskog rata”, *Istorijski Zapsi*, 1-2/1970; “O neuspehu jugoslavenske albanske trgovine, 1929-1934”, *Gjurmime*

Në Arkivat e ndryshme të Beogradit, një dëshmi-dokument për këtë "marrëveshje" nuk kanë gjetur as disa studiues dhe hulumtues kosovarë, të cilët janë antizogistë të përbetuar sot e kësaj dite, dhe po ta kishin me shumë ëndje do ta botonin.

Ndërkaq, përgjatë viteve 1975-1982 unë kam hulumtuar në të gjitha arkivat jugosllavë ku ruhet materiali për Shqipërinë-marrëdhëniet e saj me Jugosllavinë (1924-1939); të gjitha fondet e këtyre arkivave për të cilët është supozuar se mund të ketë burime për objektin e studimit tim dhe të gjitha dosjet e tyre etj. Dhe, në asnjërin prej tyre nuk kam hasur në një marrëveshje, as me shkrim e as gojore, e as pesë pikëshe e as gjashtëmbëdhjetë pikëshe, madje as të dhëna rrethanore për ndonjë marrëveshje, përveç Elaboratit të përmendur. Kur e kemi fjalën te të dhënat rrethanore: Ato mungojnë plotësisht jo vetëm në burimet arkivore shqiptare të kohës po dhe në ato jugosllave. Prandaj shtrohet çështja:

A ka pasur qoftë edhe një "lloj marrëveshje gojore" midis A. Zogut dhe qeverisë së Beogradit në vitin 1924 në formën që paraqitet në Elaboratin e vitit 1952?

Siç u pa, Avramovski është shumë i kujdesshëm dhe flet për një "lloj "Marrëveshje xhentëlmene"", gjithnjë në thonjëza. Ndërsa kur unë po përmendja një marrëveshje gojore "midis Zogut dhe qeverisë jugosllave"⁷⁵ në një punim që ishte pjesë e magistraturës (1977) nuk mund të them se kam pasur njohuri të plota për finesat e marrëdhënieve diplomatike dhe produktet periferike të tyre, siç mund të jetë një marrëveshje gojore apo si njihet ndryshe "marrëveshje xhentëlmene"⁷⁶. Kështu del se unë kam "avancuar" predispozitën e shprehur me gojë të A. Zogut në një "marrëveshje gojore", gjithnjë sipas kujtimeve (Elaboratit)

Albanologjike, 2, Prishtinë: 1969; "Çështja shqiptare në shtypin e PKJ 1919-1939", *Gjurmime Albanologjike*, I, Prishtinë: 1971.

⁷⁵ Emine Arifi-Bakalli, *Qeveria demokratike ...*. Në f. 247-248 të këtij punimi shih mënyrën e transmetimit tim të pjesës së Elaboratit që ka të bëjë me këtë çështje.

⁷⁶ Sintagma "Marrëveshje xhentëlmene" e cila mbulon një lloj marrëveshje mbi bazën e vullnetit të mirë të palëve, ka nisur të përdoret nga qarqet qeverisëse të ShBA-së në vitin 1907 në kohën e Presidentit Ruzvelt, kur midis ShBA dhe Japonisë u arrit pëlqimi për frenimin e emigracionit ekonomik nga ky vend: që autoritetet japoneze të vështirësonin pajisjen me pasaporta të qytetarëve të vet, ndërsa ShBA-ja premtoi se fëmijëve të emigracionit japonez do t'u lejohej vijimi i shkollës së bashku me të tjerët.

të një zyrtari që nuk ka pasur qasje të drejtpërdrejtë dhe as rol në bërjen e politikave të mëdha të Beogradit⁷⁷.

Prandaj çështja mbetet e hapur: a kishte apo nuk kishte marrëveshje goftë edhe në formatin e asaj që gjendet në Elaboratin e shfrytëzuar nga Avramovski dhe unë? Ajo që të bën të dyshosh është fakti se kur po zhvilloheshin negociata të rënda Beograd-Tiranë lidhur me Shën Naumin⁷⁸, apo në raste të tjera shumë të acaruara deri në ndërprerje të marrëdhënieve diplomatike (verë 1927), si dhe më vonë deri në vitin 1939, në burimet arkivore jugosllave mungon plotësisht subjekti *marrëveshje ndërmjet A. Zogut dhe qeveritarëve të Beogradit të vitit 1924*. Pra, “Marrëveshja” nuk përmendet as në komunikimin e brendshëm të politikës-diplomacisë jugosllave në dokumente tepër sekret të kohës dhe as në komunikimin në “katër sy” midis diplomatëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë dhe në fund të fundit me vetë A. Zogun.

Pas furtunave të mëdha në marrëdhëniet midis dy vendeve, kah fundi i vitit 1928 në Tiranë qëndroi Milosav Jeliqi⁷⁹, i cili hiqej si mik personal i Zogut dhe që kishte autorësinë e përgatitjes së operacionit për kthimin e Zogut në Shqipëri, gjë që do të thotë se ky ishte në dijeni të gjithçkaje që kishte ndodhur në vitin 1924. Për këtë vizitë dhe për bisedën që zhvilloi me mbretin e posa shpallur shqiptar, Jeliqi përgatiti një raport për mbretin Aleksandër. Pasi e falënderonte Jeliqin po dhe mbretin Aleksandër për ndihmën në të kaluarën, Zogu potenconte se “...në shtypin e disponuar armiqësisht ndaj meje dhe në shumë raste të tjera pohohet se unë ia kam shitur vendin tim Italisë ... nëse diku në botë ekziston ndonjë i parë i shtetit, i cili do ta shiste vendin e vet atëherë unë jam njëri prej tyre ... unë do të dëshiroja marrëdhënie më se të mira me Jugosllavinë. Unë për këtë arsye i kam ndjekur komitët bullgarë. Askush për këtë gjë nuk më ka këshilluar. Vetëm Anglia gjithnjë më ka sugjeruar që të kemi

⁷⁷ Se ky person nuk ka qenë në rrethin e ngushtë të politikanëve të Beogradit dhe që nuk ka pasur informacion të plotë për zhvillimet, hetohet fare qartë nga Elaborati në fjalë.

⁷⁸ *Britanci o Kraljevini Jugoslaviji (1921-1930)*, Zagreb: Globus, 1986; Përmbledhje dokumentesh britanike të përgatitur nga Zh. Avramovski; f. 235, Raporti vjetor për vitin 1924, legata Britanike në Beograd: “Pas kthimit në pushtet të Ahmet Zogut, Z. Niçiq pa pushim ka potencuar se nga ai nuk është kërkuar asnjë premtim, si lidhur me Shën Naumin ashtu edhe lidhur me çështjet e tjera të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet e Shqipërisë dhe vendit të tij”.

⁷⁹ Milosav Jelić i besuar i mbretit Aleksandër.

marrëdhënie të mira me Jugosllavinë ...”⁸⁰. Në raportin e Milosav Jeliqit nuk ka asnjë koment e në frymën e “Marrëveshjes së vitit 1924”.

Marenglen Verli në punimin e përmendur nënvizon se historiografia shqiptare “ndonëse e ka njohur akordin e 1924 nuk është ndalur për ta analizuar atë në mënyrë të veçantë”.⁸¹ Në fakt mund të thuhet se kjo historiografi “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshin” e ka nihiluar plotësisht. Përse? Sigurisht sepse nuk i ka besuar. Apo do të thosha që antipatia ndaj Zogut nuk ka arritur ta mundë profesionalizmin e disa profesorëve tanë të formuar para dhe kryesisht jashtë *logjikës historike* të Vëllait të Madh. Dhe prandaj “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshi” nuk zë vend as në Sintezat historiografike institucionale të Historisë së Shqipërisë-shqiptarëve (tri sosh)⁸², as në punimet e tyre që kanë të bëjnë me këtë periudhë madje pikërisht edhe me këtë vit⁸³ e as në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar⁸⁴ e as në ...

Po kjo ndodh edhe me studiuesit e huaj për Shqipërinë. Madje as studiuesi Bernd Fischer⁸⁵, i cili Ahmet Zogun e radhit në mesin e

⁸⁰ DASSIP, Zbirka V. Jovanovića-Maramboa, F-19, Albanija, Raport për L.M. Mbretin për porositë e mbretit shqiptar Zogut I, Beograd 13 shkurt 1929, nga Milosav Jeliç.

⁸¹ M. Verli, *Kosova në fokusin ...*, f. 177-179.

⁸² Kjo “marrëveshje” nuk figuron as në sintezën kolektive historiografike në Historinë e Shqipërisë të vitit 1965; as në atë të vitit 1984 dhe as në këtë të fundit të botuar në vitin 2007: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë.

⁸³ Kjo “marrëveshje” nuk figuron në veprën historiografike të Prof. Arben Puto, si: *Demokracia e rrethuar*, Tiranë: 8 Nëntori, 1990; *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës I Botërore*, III, Tiranë: Albin, 2001, f. 86; Puto evidencon vetëm: “Angazhimi jugosllav në këtë lëvizje (ndihma dhënë Zogut) mund të ketë pasur prapa mjaft kushte, por pa dyshim një ndër to, dhe ndoshta kryesori, ka qenë premtimi i Zogut për t’ia dhënë Shën Naumin Jugosllavisë, pavarësisht nga zgjidhja që iu dha çështjes në shkallë ndërkombëtare.”; Historiana Valentina Duka “marrëveshjen” në fjalë nuk e evidencon fare; *Historia e Shqipërisë (1912-2000)*, Tiranë: “Kristalina KH”, 2007; Ilir Ushtelenca, *Diplomacia e mbretit Zogu I*, Tiranë: 1995 f. 66. Ky autor pohon se përkundër bisedimeve të Zogut me autoritetet e Beogradit “deri më sot historia s’njeh asnjë marrëveshje, dokument apo premtim zyrtar që të jetë nënshkruar midis tij dhe qeverisë jugosllave”; Pranvera Teli-Dibra, *Shqipëria dhe diplomacia angleze 1919-1927*, Tiranë: 2002, 249, kufizohet në sa vijon “... me marrëveshjen e gushtit 1924 ku kundrejt disa ndihmave që Beogradi i jepte A. Zogut për të marrë pushtetin, Beogradi shpresonte të siguronte një qëndrim projugosllav të qeverisë së Tiranës”, etj.

⁸⁴ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2009.

⁸⁵ *Diktatorët e Ballkanit*, redaksia e Bernd J. Fischer, AIIS, Tiranë: 2008.

diktatorëve ballkanas, dhe tek i cili hetohet një lloj tensioni emocional antizogist dhe përdorimi i një terminologjie joadekuate, madje do të thosha përçmuese, nuk ndalet në ndonjë Marrëveshje Zogu-Pashiq.

Shtrohet çështja: si është e mundshme që këta historianë të besojnë kaq fuqishëm në këtë “dokument” përkundër faktit që ndonjëri prej tyre pretendon se kanë pasur në dorë jo vetëm dokumentacionin e kohës shqiptar, po madje edhe atë jugosllav. Si është e mundshme që Ahmet Zogut t’i imputohet diçka e tillë: jo tradhti dosido po një tradhti e plotë, dhe që nuk mund të përliqet me asgjë.

Fan Noli i ikur në Itali dhe në gjendje të dërrmuar shpirtërore para gazetarëve po deklaronte se, “Zogu ka marr ndihmë nga qeveria e Beogradit, por kjo nuk do të thotë që do t’i nënshtrohet asaj. Sapo të qetësohet situata në Shqipëri, Zogu do të veprojë si edhe ai: do të luftojë për pavarësinë e Shqipërisë”⁸⁶. Kurse një tjetër personalitet i asaj kohe edhe ky i armiqësuar me Zogun, Nikollë Ivanaj në kohën e kulmit të krizës në raportet shqiptaro-jugosllave pas Paktit të Parë të Tiranës, në gazetën gjysmëzyrtare beogradase *Politika* botoi dy artikuj të gjatë me titull: “Çështja Shqiptare”, ku ndër të tjera thuhej: “ ... Ndërkaq, nëse populli shqiptar detyrohet me forcë që të zgjedhë robërinë ekonomike dhe politike nga Italia (e cila fshihet pas maskës të mbrojtjes dhe zgjerimit të Shqipërisë), ose jo vetëm robërimin ekonomik dhe politik, por edhe ndarjen dhe asimilimin e Shqipërisë dhe të popullit të saj në mes të Jugosllavisë dhe Greqisë, dihet se çka do të zgjidhte ai. Ky mendon (populli shqiptar) se protektorati ose dhe okupimi nga Italia, të cilin ai e ka provuar njëherë, do të ishte i përkohshëm dhe jetëshkurtër, përafërsisht sa edhe fashizmi italian”⁸⁷. Sigurisht që ky artikull më shumë u drejtohej qarqeve ekstreme politike beogradase të cilat me qëndrimin e tyre dhe sidomos me politikën subversive antishqiptare (Kryengritja e Dom Loro Cakës e veprime të tjera para kësaj kryengritjeje) e favorizuan Paktin e Parë të Tiranës (27 nëntor 1926), të cilin disa muaj më parë Tirana zyrtare e refuzoi dhe alarmoi⁸⁸. Pra, atë që po paralajmëronte Ivanaj ishte se, nëse Beogradi vazhdonte me këto avaze, dihej cili do të

⁸⁶ *Novosti* (Beograd), 3 janar 1925, f. 1; Përmes kësaj deklarate Noli e pranoi që e kanë nënvlerësuar A. Zogun, por shprehu besimin se ai do të organizojë një qeveri afrimi dhe nuk do të bëjë përmendje të madhe të kundërshtarëve.

⁸⁷ *Politika*, 16 janar 1927, f. 1.

⁸⁸ Emine Arifi-Bakalli, “Pakti i Parë i Tiranës dhe Mbretëria SKS”, *Përparimi*, 6, Prishtinë, 1979.

ishte rezultati final e të cilin vetë “populli shqiptar” do ta pranonte si një të keqe më të vogël dhe kalimtare.

Shumë mendimtarë e teoricienë e ndër ta dhe Gëte i madh e kanë cekur atë që historianët do të duhej ta dinim që në fillimet e tyre profesionale: rëndësinë e kontekstit historik në rastin e profilizimit të personaliteteve historike. Është shumë lehtë të besosh në diçka apo në gjithçka jashtë kontekstit të dhënë historik. Pra, mund të besosh që Ahmet Zogu, hiç më pak se merret vesh me Pashiqin për eliminimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe se ai s’ ishte veçse një anadollak Zogoll, por kjo mund të ndodhë vetëm atëherë kur ky personalitet historik të privohet nga identiteti historik i tij apo të fshihet roli i tij në procesin historik siç është: ringritja dhe funksionalizimi i shtetit shqiptar⁸⁹ si dhe përpjekjet për evropeizimin (oksidantizimin) e tij në të gjitha planet dhe madje edhe në atë shoqëror përmes një inxhinierie⁹⁰ që nuk nënkupton vetëm norma ligjore adekuate po dhe krijim klime për jetësimin e tyre.

Burimet arkivore jugosllave të periudhës ndërmjet dy Luftërave Botërore, po dhe Elaborati i vitit 1952, dëshmojnë se rrugëtimi i Beogradit me Zogun shkonte vetëm deri sa politikës së tij të jashtme i interesonte një Shqipëri e pavarur⁹¹ si mburojë ndaj synimeve italiane në

⁸⁹ Kushdo që ka pasur në dorë burimet dokumentare jugosllave të periudhës midis dy Luftërave Botërore do të duhej të dinte cili ka qenë karakteri i komunikimit të Tiranës zyrtare me Beogradin zyrtar: komunikim intim e nënshtues apo komunikim partneriteti e bashkëpunimi në saje të interesit reciprok. Pavarësia e Shqipërisë në saje të një përcaktimi real dhe veprimi konkret i Jugosllavisë që do të shprehej përmes: heqjes dorë nga veprimet subversive për destabilizimin e Shqipërisë duke e përkrahur emigracionin politik shqiptar; përmirësimin sado pak të pozitës së shqiptarëve (të hiqej dorë nga përndjekja e tyre) në Jugosllavi dhe duke ju njohur të drejta elementare minoritare siç ishte shkollimi fillor në gjuhën e tyre etj.; ndihmës financiare dhe bashkëpunimit ekonomik duke pasur parasysh edhe interesin e Shqipërisë... Për këtë shih te: Emine Arifi-Bakalli, *Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave (1929-1939)*, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë 1997; po ajo, “Çështje nga Historia moderne dhe Bashkëkohore shqiptare”, Instituti Albanologjik-Prishtinë, Prishtinë: 2011, dhe punime të tjera të botuara në revistat shkencore në Kosovë dhe Shqipëri.

⁹⁰ Kodi civil i vitit 1929 etj.; Fjalimi i Mbretit Zog në Dhomën e Deputetëve më 10 dhjetor 1928: “... Zakonet e shpifura prej okupacione të ndryshme të kohërave të kaluara, që nuk puqen me karakterin dhe interesat e Kombit tonë, do t’i zhdukim duke vënë në vend të tyre zakonet e popujve të qytetëruar”. Hysen Selmani, *Nga notimet e Zogut I Mbretit të Shqiptarëve*, Tiranë: 2008, f. 211.

⁹¹ Nikolla Pashiq lidhur me Shqipërinë diplomatët e ri i udhëzonte sa vijon: “Ne jemi për një Shqipëri të pavarur, por të dobët dhe të pakonsoliduar”; në një referat të përgatitur pas Paktit të parë të Tiranës, thuhej: “Kur Shqipëria nuk mund të jetë e jona

këtë pjesë të Ballkanit. Hapi tjetër, ai final drejt eliminimit të Shqipërisë përkatësisht gllabërimit të saj, nënkuptonte dhe eliminimin e Zogut⁹². Për këtë fazë paramendoheshin “partnerë” të tjerë, si bie fjala Ceno Kryeziu⁹³ deri në vdekjen e tij. Më vonë Beogradi ishte në kërkim të tyre dhe jo pak nga emigracioni politik shqiptar brenda e jashtë Jugosllavisë subvencionoheshin nga kjo anë.

Si përmbyllje: Është mendim i përhapur se trajtimi i temave nga Historia Bashkëkohore është punë shumë delikate. Kjo për shumë arsye dhe posaçërisht për faktin e relacionit të fuqishëm të së sotmes me zhvillimet e të së djeshmes së afërt, sidomos në shoqëritë si dhe komunitetet historiografike me prirje për të instrumentalizuar të kaluarën për interesa politike të ditës, të ndonjë interesi tjetër edhe më meskin, apo thjesht në pamundësi që gjërat t’i shohin në përmasat reale dhe jashtë perceptimeve subjektive të tyre. Në këto rrethana dalin shumë humbës: në radhë të parë historiografia, në radhë të dytë historia dhe si rrjedhojë humbësi më i madh në këto raste është e gjithë shoqëria. Bie fjala, çka nëse nxënësit shqiptarë mësojnë për mbretin tradhtar përmendorja e të cilit qëndron në një shesh të kryeqytetit të tyre? Çka nëse shoqëria shqiptare bindet në ekzistencën dhe vërtetësinë e “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit” dhe vepron në frymën e këtij besimi. Dhe çka nëse pas kësaj një ditë diku në arkivat e ku ta dimë kujt, identifikohet autori dhe prapaskaena e vërtetë e “Gjashtëmbëdhjetë Pikëshit”? Tepër vonë.

dhe as me ne, ajo patjetër duhet të jetë plotësisht e lirë dhe e pavarur, në mënyrë që më lehtë të kontrollohet qëndrimi i saj në aspektin politik dhe konform këtij qëndrimi të modifikojmë qëndrimin tonë...”; *AVII*, P-17, k-95-g, f. 1, f. 8.

⁹² Takimi në Belje-Slloveni më 19-20 janar 1939, midis ministrit të Jashtëm italian Galeaco Çiano dhe kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë Millan Stojadinoviq, haptas u fol për zhdukjen e Shqipërisë përmes ndarjes-copëtimit të saj; dhe natyrshëm prolog i këtij zhvillimi ishte eliminimi i Zogut. Prandaj Stojadinoviqi propozonte që Zogu të zëvendësohej me ndonjë personalitet tjetër, por nuk kishte ndonjë propozim të veçantë; *Tajni Arhivi Grofa Čiana*, Zagreb 1952, f. 282; për këtë shih dhe kujtimet e kryeministrit jugosllav, Millan Stojadinoviq, *Ni rat ni pakt*, Otokar Krešovani, Rijeka 1970; Jacob B. *Hoptner, Jugoslavija u krizi 1934-1941*, Otokar Krešovani, Rijeka: 1972.

⁹³ Kjo pasqyrohet në Elaboratin në shqyrtim dhe nga dokumentacioni tjetër jugosllav i kësaj kohe. Ceno Kryeziu ishte shumë intim me zyrtarët serbë dhe i përkushtuar për politikën e Beogradit ndaj Shqipërisë.

S u m m a r y

CRITICAL REVIEW OF THE INTERPRETATIONS REGARDING
THE "ZOGU-PASIC AGREEMENT OF 1924"

A part of the Albanian historiographical community even to this day continues to study and use as a reference the so-called *Zogu-Pasic Agreement of 1924*, referring to a 16 bullet point document known as "EXTRACT Copy of the Agreement concluded in Belgrade on the August of 1924, between PRESIDENT PACHICH and AHMET ZOGU" (ESTRATTO Copia dell'intesa conclusa a Belgrado nell'Agosto 1924 tra il PRESIDENTE PACHICH ed AHMET ZOGU), found on Italian Archives. This document was served to the Italian diplomatic service by the end of 1925, and in the beginning of 1926, by unnamed individuals. According to this "document", Ahmet Zogu waives away the independence of Albania and gives it to the Kingdom of Serbs, Croats and Slovenes in order to secure, as compensation for the lost independence, an administrative role in Tirana. The Authors of the writings under this review use their entire energy and knowledge towards the goal of strengthening the authenticity of this "document" and are convinced at the authenticity of the contents thereof.

From the research done in the archives of Tirana and Belgrade, the author of this review concludes that in many of the writings published in recent years there is: a lack of scientific standards regarding the identification of the authenticity of the sources- the document in hand; incorrect use and interpretation of secondary sources; manipulation of facts; fabrication of facts; and a total lack of information regarding the archives and the sources which they refer to. The reason for doing this is the sole purpose of denigration of one historical figure, Ahmet Zogu, suggesting that he is responsible for the highest possible treason.

This review aims to give a wider scope, regarding the issue in hand, to this part of the historiographic community, the wider scientific community and to the general public, by the use of necessary archival and bibliographical information, as well as an objective and critical reading of the "authentic document".